

Ali Murat Güven

**INTERVISTË ME “MBRETIN”
MUSLIMAN TË NASA-S:
PROF. DR. FAROUK EL-BAZ**

**Nga turqishtja:
mr. Rejhan Neziri**

**Kreuzlingen
Prill, 2005**

Boton:

“Hëna e Re”
Bashkësia Islame-Shqiptare
Kirchstr. 5 f
8280, Kreuzlingen, Zvicër

tel.: 0041 71 672 38 98

HYRJE

Vërtet nuk di nga duhet të filloj me prezantimin e prof. dr. Faruk el-Bazit, shkencëtarin musliman të pakapërcyeshëm. Nëse ka diçka që e di më së miri, ajo është se ai më ka dhënë mundësinë për ta bërë intervistën më të bukur e më të kuptimtë në jetën time profesionale...

Prof. Faruk el-Bazi ka një karrierë shkencore aq të jashtëzakonshme, sa që sikur të mundohesha të bëja një përmbledhje duke i kapërcyer disa tituj të saj, do t'Ju kisha bërë padrejtësi edhe Juve si lexues po edhe vetë autorit. Megjithëkëtë, unë sërish – duke u fshehur pas fjalisë së famshme të botës së mediave: “për shkak të hapësirës së ngushtë” – nga mungesa e alternativave më duhet të filloj me pikat bazë të jetës së tij.

I lindur më 1 janar 1938 në fshatin Tuk el-Aklam në Deltën e Nilit në Egjipt, el-Bazi ka qenë anëtar i një familjeje të madhe që për banim të vetin kishte shkretëtirën. Ndoshta kjo ka qenë arsyeja që ai më vonë të bëhet njëri ndër specialistët më të zgjedhur botëror në fushën e “gjeologjisë së shkretëtirës”.

El-Bazi, hapin e parë të karrierës së tij të ndritshme shkencore e bëri në vitin 1958 në Universitetin Ajnush-shems të Kajros, gjithnjë i nxitur për punë e studim nga babai i tij teolog. Këtë proces studimi ai e vazhdoi në Universitetin e Asjutit, në Shkollën e Lartë të Mineraleve e Metalurgjisë në Missouri, në Universitetin e Missouriit ku edhe doktoron dhe më pas në Universitetin e Heidelbergut.

Me personalitetin e tij që tregonte prirje për përdorimin e pajisjes shkencore në ushtrime praktike, si një kimist dhe gjeolog i suksesshëm dhe me famën e tij shkencore që dita-ditës vinte e përhapej gjithandej, el-Bazi në cilësi të specialistit fillon të punojë në kompaninë e petrolit Pan American dhe merr pjesë në punimet zbuluese të basenit të parë të naftës në Kanalën e Suezit.

Që nga viti 1967 el-Bazi pranohet në Administratën Kombëtare Aeronautike dhe Kozmike (NASA) dhe përgjatë gjashtë vjetëve merr përsipër detyra shumë të rëndësishme në Programin Apollo të Hënës, ku punoi si sekretar i përgjithshëm i “Komitetit për fiksimin e zonave të aterimit në Hënë”, inspektor kryesor në “Qendrën për vrojtimit dhe fotografim të hapësirës” dhe kryetar i “Zyrës për

trajnimin e fluturimit të astronautëve Apollo”. Gjatë kësaj periudhe angazhimi, kur u vë vulën sukseseve të tij të shkruara me shkronja të arta në historinë e shkencës, ai personalisht – si një i urtë musliman – ka bërë trajnimin shkencor të të gjithë astronautëve të Apollos. Në këtë kuptim, ai vetë kurrë nuk ka shkelë në Hënë, mirëpo ka qëndruar pas 12 personave të veçantë që patën shkelur në Hënë – thua ja sikurse i urti Yoda, mësuesi i shtatë kalorësve në filmin “Lufta e yjeve”. Këtu po e përmendim fjalën e famshme të nxënësit të tij Alfred Merril Worden, astronaut i Apollo 15, për ta përmbledhur kontributin e el-Bazit dhënë këtij operacioni. Worden, menjëherë pas kthimit nga Hëna, në një intervistë për mediat shprehet tamam kështu: “Pas trajnimit që na e bëri mbreti, derisa isha në Hënë e ndjeja veten sikur të kisha qenë edhe më parë atje”.

Shprehja “Mbret” e përdorur si titull në fillim të artikullit, mbështetet në këtë thënie të Wordenit, e nuk është një sajim imi apo një frazë heroike për ta lavdëruar një bashkëfetar timin musliman që ka shënuar një sukses të jashtëzakonshëm në fushën e veprimit të vet. Në kërkimet paraprake që kam bërë, mësova se astronautët e Apollos që kishin kaluar nëpër duart dhe katedrën e el-Bazit ndjenin një mahnitje e simpati të jashtëzakonshme ndaj tij dhe se në bisedat me njëri-tjetrin atij ia kishin ngjitur ofiqin “mbret”. Prandaj edhe unë në fillim atë e përmenda me të njëjtin ofiq.

El-Bazi, i cili pas mbarimit të Programit Hënor Apollo u mbulua me çmime e dhurata nga më të ndryshmet dhe nga Instituti Smithson u ngarkua të themelonte një “Qendër të studimit të planetëve”, gjatë viteve 1973-1975 ka marrë pjesë aktive edhe në projektin Apollo-Sojuz, kur amerikanët dhe rusët për herë të parë kanë bashkëpunuar në planin e studimit të hapësirës.

Në vitet 1980 el-Bazi udhëheq disa kërkime lidhur me gjeologjinë e shkretëtirës për National Geographic Society dhe të njëjtat i boton në revistën e famshme “të verdhë” të të njëjtës Shoqatë, kurse në periudhën e “anijeve kozmike”, që quhet periudha e dytë e hapësirës, e nxjerr në pah specializimin e tij në lëmin e optikës dhe e shohim ta ketë projektuar kamerën këndgjerrë të nevojitur për regjistrimin e fotografive cilësore në hapësirë nga ana e këtyre anijeve. Sot e kësaj dite el-Bazi në shumë institucione shkencore me renome ka participuar si akademik, anëtar kryesie, drejtues dhe ka fituar çmime, çmime, çmime... Më në fund e gjejmë si drejtues në “Qendrën për teleperceptim” (Center for Remote Sensing) pranë Universitetit të Bostonit...

Në kuptimin e plotë të fjalës jemi përballë një të urti “të pakapërcyeshëm”! Nëse doni të mësoni më tepër për karrierën e tij të jashtëzakonshme shkencore, ju lutem hidhni një shikim biografisë së tij të publikuar në këtë web faqe të Universitetit të Bostonit:

www.bu.edu/remotesensing/Faculty/El-Baz/FEBbio.html

*Këtë intervistë që e keni para vetes e kemi zhvilluar me anë të internetit në muajt korrik dhe gusht të vitit 2004. Këtë do ta keni të ndarë në pesë pjesë, duke shpresuar se edhe ju si lexues shqiptarë do ta lexoni me të njëjtin interesim, entuziazëm e kërshtëri të plotë sikur çdo lexues tjetër turk, kur u botua për herë të parë në gazetën ditore turke **Yeni Şafak**, të datës 30 gusht – 3 shtator 2004 (<http://www.yenisafak.com.tr/diziler/nasa/index.html>). Me këtë rast i jam mirënjohës edhe mr. Rejhan Nezirit i cili qysh në ditët e para sapo u botua intervista shprehu gatishmërinë për ta përkthyer atë në gjuhën shqipe, çka më impresionoi edhe një herë një shqiptar për ndjeshmërinë që keni ju si popull ndaj vlerave dhe kulturës islame, pas vizitës prej së afërmi të ngjarjeve të luftës së Kosovës kur pata përgatitur një dokumentar lidhur me refugjatët kosovarë që pritnin në kufirin Kosovë-Maqedoni. Zoti mos na sprovoftë më me skena të këtilla! Gjitha të mirat, vëllai juaj nga Stambolli!*

Ali Murat Güven

02. 10. 2004

Armstrongu kurrë nuk u bë musliman

- Profesor i nderuar, në emër të gazetës ditore “**Yeni Şafak**” fillimisht Ju falënderoj për zemërsisht për gatishmërinë Tuaj që pranuat zhvillimin e kësaj interviste. Besoj se thëniet Tuaja do të jenë fitimprurëse për lexuesin turk musliman, po edhe për të gjithë ata muslimanë që do ta lexojnë këtë më pas të përkthyer në gjuhë të huaja.

Në botën islame, kur është në pyetje relacioni midis “Islamit” dhe “shkencave pozitive”, për fat të keq qarkullojnë një sërë të thënash e besëtytnish edhe atë mu përpara syve të shkencëtarëve me peshë sikurse Ju. Më e njohura prej këtyre është thënia çerekshekullore kinse astronauti i Apollos 11, Neil Armstrong, kur ka mbërritur në Hënë e ka dëgjuar “zërin e ezanit” dhe se më pas ai e ka pranuar Islamin... Me sa jam i informuar unë, z. Armstrong disa herë në mënyrë tejet të qytetëruar i ka përgënjeshtuar këto të thëna. Mirëpo, përkundër kësaj në botën islame një numër tejet i madh i muslimanëve vazhdojnë t’i besojnë kësaj të thëne.*

Kësaj radhe edhe një herë dëshirojmë prej gojës Suaj të dëgjojmë të vërtetën që fshihet pas këtyre supozimeve lodhëse që vërtet e përçmojnë botën islame. A keni ndonjë miqësi personale me z. Armstrong? Sa është e vërtetë kjo thënie e sajuar në adresë të tijën?

- Neil Armstrongun dhe të gjithë astronautët e tjerë të Apollos i njoh për së afërmi, ngase thujse të gjithë këta unë i kam ushtruar e përgatitur për të ateruar në faqen e Hënës. Kanë kaluar tamam 35 vjet që kur Armstrongu zbriti në Hënë, mirëpo sot e kësaj dite edhe me të por edhe me shumë astronautë të tjerë akoma kam marrëdhënie të ngushta miqësore. Kjo nga arsyeja se ne si një ekip i veçantë e kemi ndarë gëzimin për realizimin e elanit më të rëndësishëm shkencor të shek. XX.

Me këtë pyetje të rëndësishme, i dashuri Ali, ke prekur një çështje që vërtet dhe mua po më ha me vite të tëra... Përmes teje dhe gazetës suaj, të gjithë vëllezërve turq po edhe atyre që rastësisht do ta lexojnë të përkthyer në gjuhë të tjera, po ju them me një theks të veçantë se NEIL ARMSTRONGU NË HËNË NUK KA DËGJUAR ASNJË LLOJ ZËRI MISTERIOZ QË DO TË MUND TË QUHEJ “ZË EZANI” DHE DERI MË SOT KUR PO E ZHVILLOJMË KËTË INTERVISTË AI NUK KA DEKLARUAR SE ËSHTË BËRË MUSLIMAN. Për më tepër, unë si një shkencëtar musliman, mendoj se ai as që ka nevojë të marrë një vendim të këtillë.

* Nëse dëshironi të dini se në ç’mënyrë jomuslimanët dhe ateistët tallen me muslimanët që hedhin supozime të këtilla, ja një adresë interneti: www.answering-islam.org/Hoaxes/neil.html.

Thashethemet e këtilla boshe më lëndojnë thellë edhe mua po edhe të gjithë muslimanët e ndjeshëm. Sipas atyre që e mbrojnë një qasje të këtillë, Islami bëhet “një gjë e mirë” dhe e forcon autoritetin në shkallë globale vetëm atëherë kur një njeri me famë botërore deklaron se e ka përqaftuar fenë Islame. Ndërkaq unë si një musliman i përkushtuar nuk mund të paramendoj ndonjë qasje më të poshtër e ndonjë përçmim më të madh që mund t’i bëhet Islamit sesa ky pretendim.

Neili tani është në moshën 74 vjeçare dhe me familjen e tij në Ohio çon një jetë të vetmuar murgërore. Ai është 8 vjet më i moshuar se unë. Sikur një ditë të deklaronte se me dëshirën e tij ka kaluar në Islam, kjo sigurisht që do të na gëzonte të gjithë neve. Po mirë, çka nëse ai nuk bëhet musliman, Islami 14 shekullor a do ta humbasë kuptimin dhe peshën e vet? Që muslimanët t’i besojnë fesë së tyre a thua patjetër duhet të kenë nevojë për një argument “perëndimor”? Ata që mendojnë se kështu duhet të jetë, edhe ashtu s’ka nevojë të thirren në këtë fe. Për ata që duan të strehohen nën hijen e një dëshmie të këtillë që të bie në sy, për ata që gjejnë qetësinë vetëm me dokrra të këtilla, nëse doni unë mund t’ua sjell dëshminë më të mirë e më bindëse. Po, po e përsëris, Neil Armstrongu dhe asnjë astronaut tjetër i Apollos akoma nuk e ka pranuar Islamin. Mirëpo unë, si një pedagog që të gjithë këta një nga një i kam arsimuar dhe në mënyrë të sigurt i kam dërguar në Hënë dhe kthyer prapë, jam musliman prej ditës kur më ka lindur nëna! Qartë? A u mjafton atyre kjo dëshmi?

- Pas këtij sqarimi nga goja më kompetente, besoj se edhe kjo përrallë do të hidhet në vendin që e meriton, pra në shportën e hedhurinave të historisë së miteve. Mirë ama, nëse kjo e thënë nuk është e vërtetë, si lindi ajo? A keni ndonjë njohuri më të veçantë lidhur me paraqitjen e rrëfenjës së zërit të ezanit në Hënë apo me atë të Islamit të Armstrongut?

- Për fat të keq, ka. Në fakt, shkakut i paraqitjes së kësaj rrëfenje, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, është një gjest imi që unë kërkova prej astronautëve të bënin kur të mbërrinin në Hënë. Mirëpo, nga ta dija se një kërkesë e këtillë e virgjër mund të lindte dokrra të këtilla marramendëse...

- Profesor, po më bëni merak. Ç’kërkuat prej astronautëve të bënin?

- Ishte njëri prej tri astronautëve të Apollos 15, nxënësi im Alfred Merrill Worden. Lexuesit tuaj të interesuar për studime hapësinore do të rikujtojnë se fluturimet Apollo gjithnjë bëheshin në grupe prej tri astronautësh. Dy prej tyre, me anë të pajisjes që ne e quajmë “modul hënor” (Lunar Module) zbresin në sipërfaqen e satelitit tonë (Hënës) dhe i kryejnë kërkimet e tyre shkencore, kurse

i treti me pajisjen “moduli komandues” (Command Module) duke bërë xhiro në orbitën e Hënës i pret ata dy, me ç’rast mban edhe lidhjet me Tokën. Në këtë fluturim David Scott dhe James Irwin ishin dyshi që do të zbritnin në Hënë, kurse Worden ishte pilot i modulit komandues...

Kur moduli komandues “Endeavour” u fut në orbitën e Hënës dhe filloi të sillej rreth saj, Wordeni filloi t’i bënte zë e t’i raportonte Houstonit nga një largësi prej 380 mijë kilometrash. Me këtë rast, mes nesh u bënë disa biseda miqësore me anë të telepajisjeve. Një herë si me shaka më tha: “Mbret, a dëshiron diçka prej këtu?” I thash: “Mjafton ta përkthesh Tokën në gjuhën arabe”. Me këtë rast desha që së paku një herë të kumbonte gjuha e Kur’anit në orbitën e Hënës. Wordeni gjatë mësimëve shumëvjeçare prej meje arriti të mësonte edhe nja katër-pesë fjalë arabisht. Nuk ma theu dëshirën dhe me anë të telepajisjes tha pikërisht këtë: “Merhaba ehlel-erd, min Endeavour alejkum selam”, pra, “Tungjatjeta o banorë të Tokës, selam nga Endeavour!”.

Këto fjalë u dëgjuan si nga ne që asokohe ishim në selinë komanduese në Houston ashtu edhe nga mijëra radiotelefonikë amatorë që nga të katër anët e botës e ndiqnin rrugëtimin e Apollos 15 dhe menjëherë i regjistruan këto fjalë megjithëse shumica prej tyre nuk e njihnin gjuhën arabe. Më pastaj mendoj se kjo u ndryshua e u përdhos aq shumë sa që u përhap në mbarë botën islame në këtë formë të çuditshme. Mirëpo, ku është zëri i ezanit e ku ajo përkthet miqësore e Wordenit që ma bëri mua? Mes tyre nuk ka asnjëfarë afërsie fonetike bile. E pra, për më tepër, ky mit është trilluar për Apollon 11, pra për një fluturim tjetër që është bërë plotë dy vjet para Apollos 15. Mes tyre nuk ka as edhe lidhje apo afërsi kronologjike bile.

T’jua them vetëm këtë: Unë isha njëri prej atyre në numër të kufizuar të personave që i dëgjonim të gjitha bisedat e kontrollit tokësor dhe astronautëve gjatë fluturimeve të Apollos. Sikur të kishte ndonjë zë ezani, i pari që do ta kuptonte do të isha unë si një që e njoh gjuhën arabe. Mirëpo një gjë e këtillë kurrë nuk ka ndodhur.

Lidhur me këtë, rinisë islame përfundimisht do t’i kisha thënë: Islami është feja e pashembullt që me mesazhin e saj hyjnor të formuluar më së miri në Kur’anin fisnik ndiqet nga ana e mbi një miliardë njerëzve. Dhe për ta shprehur më mirë vetveten nuk ka nevojë për asnjë provë tjetër pos kësaj. Madje vetë Kur’ani është dëshmia më e madhe.

- Ju faleminderit shumë! Me këtë i keni vënë pikën e fundit kësaj të thënë mërzitëse e marramendëse që po sorollatet nëpër kokat e njerëzve. Pyetja ime e radhës ka të bëjë paksa me paraprakën. Ju jeni një shkencëtar përpara të cilit me nderimet më të larta përkulet e gjithë bota, po jeni edhe një musliman i vërtetë e i vendosur që kurrë nuk keni nguruar ta deklaroni

veten se jeni pjesëtar i fesë islame. Me këtë Ju përbëni shembullin mahnitës se si duhet të duket një shkencëtar musliman.

Në mesin e popujve muslimanë ekziston një prirje e çuditshme që dijetarët, muzikantët, artistët etj., që janë me përkatësi fetare joislame, t'i shpallin si muslimanë, para se ata vetë të deklarohen për këtë. Para do kohësh nëpër disa media të muslimanëve kemi pasur rastin të dëgjojmë për Islamin e Anthony Qunit, Jacques Yves Cousteaus e të Michael Jacksonit etj. Pas kësaj menjëherë kemi vërshimin e artikujve të jomuslimanëve ku në mënyrë tejet përçmuese tallen me këto gjeste të mediave muslimane e me muslimanët në përgjithësi. Kjo na shqetëson tej mase. Ju lutem, nëse një shkencëtar apo artist perëndimor deklaron se është kthyer në Islam, me këtë deklaratë a përfiton e ngrihet Islami, apo vetë ai që e pranon Islamin? A nuk e zvogëlon imazhin e Islamit prirja për të pritur gjëra të këtilla nga këto konvertime në Islam?

- Përgjigjja ime në këtë pyetje do të ketë karakter plotësues të asaj që e thash më lart. Të besosh ose ta përforcosh një besim të luhatshëm duke pritur lajmet për kalimin në Islam të disa personaliteteve të mëdha e të famshme, sipas meje është një gjendje e sëmurë psikologjike. Me kalimin në Islam të një personi të famshëm – madje edhe fare të pafamshëm, kemi të bëjmë me një “fitore personale” dhe kjo nuk ia shton madhërinë Islamit as sa edhe një kokërr meli. Muslimanët që ushqejnë mendime të këtilla, sa më parë duhet t'i flakin këto botëkuptime të sëmura dhe duhet ta kthejnë vetëbesimin. Ata janë njerëzit që e kanë pranuar mesazhin më të ndershëm të gjithësisë dhe këtë ata s'duhet kurrë ta harrojnë! Një ditë do ta braktisim këtë botë dhe All-llahu xh.sh. nuk do të shikojë se cili prej nesh ka qenë artist që ka fituar çmimin Oscar, cili prej nesh ka qenë astronaut që ka zbritur në Hënë e cili ka qenë ylli i muzikës pop që ka fituar çmimin Grammy. Ai do të na pyesë vetëm këtë: “Sa e pranove dhe përvetësove mesazhin Tim të fundit që ta dërgova, o robi Im?” Mendoj që kjo të jetë një gjë më se e qartë për ata që besojnë Islamin me gjithë zemër...



Prof. Dr. El-Bazi, i rrethuar nga nxënësit e tij astronautë të Apollos, në takimin “Lamtumirë Apollo”, të organizuar në Wisconsin-Oshkosh në vitin 1994... Nga e majta në të djathtë: Michael Collins (Apollo 11), Richard Gordon (Apollo 12), Stuart Roosa (Apollo 14), Alfred Worden (Apollo 15).

‘Mund të bëj llogaritjen edhe të kokrrave të rërës së një shkretëtire’

- Në kohën që njihet me emrin ‘periudha e artë e Islamit’, në botën Islame, njohja shkencore para së gjithash ishte prodhim i arabëve, iranianëve dhe turqve. Në kohën kur të krishterët Tokën e mendonin si një tepsi të rrafshët, shkencëtarët muslimanë në Lindjen dhe Azinë e Mesme patën ngritur observatorë mjaft të zhvilluar. Për 7-8 shekuj, nga një ummet që gjithë botës i ofronte njohuritë më të vlefshme shkencore, u bëmë ummeti që mjaftohemi me njohuritë shkencore të prodhuara vetëm në Perëndim dhe që shumë pak u shtojnë elemente të veta origjinale. Cilat janë arsytet e kësaj ngecjeje? A ju shqetëson edhe Juve kjo pamje, sikur çdo musliman tjetër, dhe a mendoni se kjo gjendje do të tejkalohet dhe se, herët a vonë, do të rikthehen ditët e rritjes së nivelit të prodhimit të njohurive shkencore?

- Qytetërimi Islam, përgjatë shekujve 8-16 shfaqti një proces rritjeje mahnitëse, ngase Islami qysh nga fillimi i tij kërkimin e diturisë e vuri në pikën më qendrore të tij. Dijetarët muslimanë pa kurrfarë kompleksi i përkthyen në gjuhën arabe tekstet e vjetra shkencore nga gjuha greke, latine, ibranishte e persishte dhe mbi to ngritën dituri krejt të reja. Ngritja dhe ndërtimi i shkollave dhe qendrave kërkuese të cilatdo lloj e cilatdo nivel si dhe sjellja e mësimdhënësve më të famshëm të kohës nëpër këto qendra e vatra arsimit, thuajse ishte bërë pasion i vërtetë i burrështetasve muslimanë. Shenjtërohej dituria, kurse ata që zbulonin gjëra të dobishme për njerëzimin shpërbleheshin me çmimet më të larta të kohës. Nuk kishte famë më të madhe se të ishte dijetar. Madje edhe sundimtarët muslimanë më madhështorë, të cilëve ua kishin dronë shtetet rivale të kohës, kur u vinin përpara dijetarët, e rregullonin vetveten në shenjë nderimi ndaj tyre dhe dijes së tyre. Historia pasislamike e arabëve, turqve dhe e persianëve ishte e mbushur përplot shembuj të këtillë.

Sipas meje, shkakun numër një i kësaj ngritjeje të shkëlqyer në botën islame dhe i nivelit kaq të lartë civilizues kanë qenë gjyshërit tanë të urtë të cilët kufijtë e shteteve, zemrat dhe mendjet e tyre i hapën deri në fund drejt dritës së shkencës. Kur ata e respektonin dhe e çmonin dijen dhe dijetarët, asnjëherë nuk shikonin në prejardhjen etnike, kombëtare apo fetare të tyre. Këta njerëz largpamës vetëm thoshin: “Dituria ngado që të vijë është e mirëseardhur, mjafton që muslimanët të zhvillohen e ngrihen në saje të saj”. Për këtë arsye një numër i madh i dijetarëve lindorë e perëndimorë emigruan për në qytetet e mëdha islame që njiheshin si qendrat më të famshme të dijes, ku ata pastaj e ndjenin veten më të qetë e më të sigurtë. Secili shkencëtar kërkon një mjedis të përshtatshëm ku me qetësi e pa probleme të mund ta vazhdojë jetën e vetë shkencore e të respektohet

për punën që bën. Unë përse me vite të tëra jam në SHBA, përse kaq shumë dijetarë arabë e turq janë të angazhuar nëpër universitete të ndryshme amerikane, angleze apo gjermane? Këtë proces emigrimi që po e përjetojmë ne sot, a nuk është i njëjti me atë të para 500 vjetëve kur dijetarët dhe artistët evropianë vërshonin drejt qendrave islame? Sot ju mund të shihni me mijëra shkencëtarë muslimanë qoftë në NASA, qoftë në institucionet më të famshme shkencore të Amerikës dhe Evropës. Sikur shtetet e tyre t'ua ofronin të njëjtat standarde ekonomike e shkencore, asnjëri prej tyre nuk do ta kishte lëshuar vendin e vet.

Bota islame sot nuk po ta gëzon shpirtin. Në shumë fusha kemi ngelur shumë prapa qytetërimit bashkëkohor. Arsyeja e kësaj është tendenca e pushtetarëve të sotëm për t'i mbyllur karshi ideve të reja edhe vetveten po edhe njerëzit që i qeverisin, me pretekst të ruajtjes nga "pushtimi kulturor" i të huajve. Këtë qasje assesi nuk mund ta pranoj si të shëndoshë. Përderisa para 900 vjetëve një Imam Gazali qetë-qetë ka mund ta lexojë Aristotelin e të krijojë antiteza të mësimeve të tij, sot kah vendet e shumta islame nuk mund të mbërrijnë as edhe botimet serioze shkencore. Nëse jetojmë me frikën se "të huajt do të vijnë e do ta pushtojnë kulturën tonë", me këtë ne do të ngecim akoma dhe më tepër. Të keni vetëbesim të shëndoshë, t'i dilni zot si burrë besimit dhe kulturës suaj e me këtë mbyllini dyert për pushtimin e kulturës suaj nga idetë e huaja! Nëse nga frika prej çfarëdo ere që vjen nga jashtë i mbyllim dyert fortë e më fortë, atëherë do të mbytemi e vdesim brenda nga mungesa e ajrit të pastër.

Gjithë shpresa ime është e varur te brezat e rinj që po rriten në botën islame. Ky brez i ri që po vjen pas nesh është i vetëdijshëm për të vërtetën dhe në një të ardhme të afërt të gjithë ata një nga një do të angazhohen në vendlindjet e tyre. Nëse këta në mënyrë të mjaftueshme e kuptojnë se shkaku i ngecjes sonë nuk është Islami porse udhëheqësit frikacakë e fanatikë që veprojnë në emër të Islamit, shumë lirshëm do të mund t'i hapin shtigjet e përparimit për popujt e tyre. Kultura islame është aq e hapur nga jashtë dhe dinamike sa që nëse nuk shkëputet nga zinxhiri i saj për asnjë moment, për një kohë shumë të shkurtër do të mund pa mëdyshje ta kapim nivelin e zhvillimit politik dhe shkencor të qytetërimit perëndimor.

Shikoni Kinën, deri dje ishte një kuti krejt e mbyllur në vetvete. Mirëpo, me dhënien fund të disa praktikave despotike, e shihni se ç'shpërthim mahnitës është duke treguar. Tanimë ata i ke në çdo fushë, në sport, art, shkencë, teknologji, tregti, turizëm...sa që janë duke u zhvilluar si një forcë që po i frikëson edhe SHBA-të.

Unë jam njëri prej shkencëtarëve të parë "perëndimorë" që kemi depërtuar në Kinë për shkaqe hulumtimi shkencor. Në vitin 1979 kur Kina vendos që sërish t'i rregullojë marrëdhëniet deri më atëherë të shkëputura me SHBA-të, unë me një grup të madh hulumtuesish shkuam në Kinë dhe në shkretëtirat e Kinës

veriperëndimore bëmë një kërkim gjeologjik gjashtëjavor. Ky studim më vonë u botua në revistën e njohur të **National Geographic Society**, kurse shteti kinez përfitoi shumë nga rezultatet shkencore të arritura nga ana jonë në përmirësimin dhe përshtatjen e shkretëtirave.

Edhe shtetet që deri në të kaluarën e afërt ishin të mbyllura si India dhe Koreja e Jugut, në vitet e fundit realizuan një hapje të rëndësishme kulturore. Në botën islame ndërkaq ka dy shtete të rëndësishme që e kanë vërejtur se nuk mund të arrijnë gjëkundi me këtë ecuri: Malajzia dhe Indonezia. Edhe ato u shkundën, e hoqën dheun e vdekur nga vetvetja dhe viteve të fundit kanë treguar një rritje të madhe. Dëshiroj që kjo valë e vetëdijesimit të përhapet për një kohë të shkurtër në gjithë botën islame. Ne nuk jemi në këtë hall pse jemi pjesëtar të qytetërimit islam, porse jemi këtu për shkak të udhëheqësve tanë të këqij, ju lutem mos e harroni kurrë këtë! Sikur shkak kryesor për ngecjen tonë të ishte Islami, atëherë nuk do të mund ta përjetonim as edhe atë “epokën e artë” me të cilën po mburremi gjithë kohën. Mirëpo ne nuk kemi arritur t’i realizojmë ato ndryshime në vetvete që po na imponojnë kohët moderne.

- Ju keni një karrierë të jashtëzakonshme shkencore. Në krye me SHBA-të Ju keni një famë të madhe në të gjitha shtetet perëndimore. Madje jemi të informuar se në NASA Ju thirrreni me nofkën “mbret”. Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA, në mbarë botën nxori kokë një kampizim i madh fetar. Qëndrimi i ftohtë e armiqësor që u shfaq ndaj muslimanëve a ka pasur ndikim edhe në jetën Tuaj akademike e private?

- Unë, gjatë dyzet viteve të kaluara edhe pse kam bërë udhëtime shkencore me afat të shkurtër në shumë vende të ndryshme, kryesisht kam jetuar në SHBA. Baza kryesore e punës dhe jetës sime ka qenë këtu. Prandaj, gjatë një jete kaq të gjatë në këtë vend, sigurisht që kam krijuar edhe shumë shokë e miq. Publiku amerikan më një mua për së afërmi. Tanimë e kam vështirë ta përkujoj numrin e pjesëmarrjes nëpër programe radio-televizive, zhvillimin e intervistave nëpër gazeta e revista si dhe pjesëmarrjen aktive nëpër konferenca shkencore. Gjatë të gjitha këtyre aktiviteteve të mia përpara publikut gjithnjë jam paraqitur me identitetin tim si një “shkencëtar musliman”.

Ngjarjet e 11 shtatorit, si çdo musliman tjetër, edhe mua më kanë prekur thellë. Natyrisht se në thellësitë e zemrës ndjeva një përgjegjësi serioze për t’ia sqaruar publikut në mënyrë të drejtë lidhjen – apo më mirë thënë moslidhjen – e Islamit me këto ngjarje tragjike. Që prej asaj date e këndeje kudo jam munduar të përfitoj nga rasti t’u tregoj turmave “Islamit e vërtetë”. Lidhur më këtë shumë herë kam folur nëpër mediat amerikane dhe jam munduar t’ua sqaroj masës dallimin e mprehtë ndërmjet Islamit si fe e madhërishtme dhe lëvizjeve terroriste të veshura me petk islam. T’Ju them me sinqeritetin më të madh se deri më sot nuk kam

pasur asnjë bezdisje, shqetësim ose sulm direkt ndaj meje personalisht ose ndaj fesë sime as nga pjesëtarët e mediave, as nga mjedisi im akademik e as nga njerëzit e thjeshtë të rrugës. Përkundrazi, me gëzim kam vërejtur ndikimin e thellë të sqarimeve të mia këmbëngulëse mbi publikun që më ka ndjekur. Shumë amerikanë ma kanë thënë hapur se pasi i kanë dëgjuar qasjet e mia rreth kësaj çështjeje u është zbutur ai zemërimi i hovit të parë dhe se kanë filluar të mendojnë paksa më me gjakftohtësi. Ata tanimë kishin kuptuar se në rrënjë të kësaj dhune të verbër nuk mund të qëndronin porositë e All-llahut.

Mirëpo, në thelb është i saktë konstatimi Juaj se sulmet e 11 shtatorit në SHBA – a thua në viset tjera ndodhi më ndryshe? – e kanë dëmtuar në njëfarë mase imazhin e Islamit. Në SHBA herë pas here dëgjohej ofendime e ngucje të ndërsjella ndër njerëzit e rrugës. Në këtë pikë ne intelektualët kemi detyra të mëdha dhe unë për çdo rast jam munduar ta sqaroj kulturën islame me aq fuqi sa më ka lëvizur goja. Për të ardhmen gjithsesi se jam optimist. Mendoj se ky është një problem kulturor të cilin do të mund ta shërojmë me kalimin e kohës.

- Meqë ra fjala për paragjykimet fetare të shoqërisë amerikane, desha ta sjell bisedën te teknika Juaj e “llogaritjes prej së largu” me rastin e së famshmes protestë të “1 milion njerëzve”. Rolin Tuaj në këtë ngjarje kam mund ta mësoj prej asaj çfarë është shkruar për Ju në internet. Çfarë ishte ajo që Ju bëtë pikërisht me rastin e kësaj proteste?

- Ju lutem, siç Jeni të informuar, momentalisht jam në krye të “Qendrës për Teleperceptim”. Ky është një institut kërkimor pranë Universitetit të Bostonit dhe unë që nga viti 1986 këtu punoj si administrator. Punën që e bëjmë ne, me fjalë të shkurtra, është që duke u mbështetur në fotografimet satelitore të kërkimeve burimet e çmueshme nëntokësore si naftën, arin e ujin në cilindo krahe të botës dhe pas një vlerësimi të qëlluar t’i gjejmë vërtet këto burime. Kjo fushë kërkimore shkencore që njihet me emrin “Remote Sensing” mund të përdoret edhe në fiksimin e çfarëdo çrregullimi në baraspeshat ekologjike, në fiksimin e viseve që u kanoset tërmeti si dhe të atyre që rrezikojnë të shndërrohen në shkretëtira. Kohëve të fundit të dhënat që i fitojmë ne përdoren me të madhe edhe në fiksimin e hapësirave më të përshtatshme për ngritjen e qyteteve. Pra, shkurt thënë, ne e “interpretojmë” nga qielli cilindo kënd të botës duke u mbështetur në shkencat e ndryshme si gjeologji, matematikë, gjeografi, optikë, kimi etj. Bagazhin tim shkencor lidhur me këtë temë unë e kam përdorur në vitet 1970 në fiksimin e problemeve lidhur me furnizimin ushqimor dhe hapësinor si pasojë e rritjes së popullsisë buzë lumit Nil dhe asokohe, si këshilltar shkencor i ish kryetarit të shtetit egjiptian Enver Sadatit që isha, duke i dorëzuar një raport shkencor ia tërhoqa vërejtjen për aplikimin e një programi që prej kësaj pjese shkretinore të përfitonte tokë pjellore. Me realizimin e këtij projekti morën frymë lirshëm edhe njerëzit e pellgut të Nilit që përballëshin me një ngushtim të

madh demografik. Pra, profesionalizimi im në këtë fushë më siguroi që tokave ku isha lindur t'u ofroja shërbimin më të mirë që mund t'ua bëja. Më vonë, studime të këtylla realizova edhe në vende me vise të ndryshme shkretinore si në Oman, Kuvajt, Katar, Emiratet e Bashkuara Arabe etj.

Tani të vijmë te çështja e “1 milion njerëzve”... Në SHBA – siç jeni të informuar – ekziston një grup islamik mjaft aktiv i quajtur “Nation of Islam” (Kombi Islam) i udhëhequr nga lideri zezak Louis Farakhan. Para shumë kohësh edhe i ndjeri Malcolm X ishte rritur brenda kësaj lëvizjeje.

Qendra drejtuese e “Kombit Islam” është në Çikago. Lideri i këtij grupi, Farakhani, në vitin 1995 nga Çikago u bën thirrje të gjithë afro-amerikanëve që jetonin në të katër anët e vendit “të marshonin drejt kryeqytetit Washington” për të protestuar kundër disa politikave diskriminuese të Shtëpisë së Bardhë ndaj zezakëve. Ky ishte një demonstrim force i rrezikshëm që do ta maste edhe karizmën e Farakhanit mbi zezakët, edhe veprimtarinë e “Kombit Islam” në shkallë vendore. Gjithkush ishte i interesuar të dinte sa vetë do t'i përgjigjeshin kësaj thirrjeje. Asokohe në Shtëpinë e Bardhë si kryetar shteti ishte Bill Clinton.

Përfundimisht në Washington u mblodh një turmë e madhe. Mirëpo kësaj radhe nga ana e politikanëve e disa organeve të mediave filluan të ngrihen zëra kritikë lidhur me “pjesëmarrjen shumë të ulët të protestuesve në vendin e takimit”. Zyra amerikane për përkujdesjen e parqeve nacionale, në bazë të të dhënave fotografike që i kishte, deklaroi se në këtë takim kishin marrë pjesë afro 400 000 vetë. Farakhani dhe ithtarët e tij së këndejmi ngulnin këmbë se edhe përkundër të gjitha pengesave të armiqve të zezakëve, kësaj radhe edhe duke e zvogëluar numrin e pjesëmarrësve, për minimizimin e veprimtarisë së tyre, deklaruan shifrën prej 1.5 milionë protestuesve. Me rritjen e kësaj në nivel të zënkave e ofendimeve të ndërsjella, qendrën kërkimore ku punoja unë e caktuan për “gjykatës shkencor”. Tre ditë radhazi pas protestës unë me dhjetë ndihmësit e mi realizuam një studim tejet të hollësishëm duke u mbështetur në fotografimet e bëra nga godinat e larta dhe nga qielli. Më në fund, më 19 tetor 1995 publikut ia kumtuam raportin tonë zyrtar: plus-minus me nja 20 % mundësi gabimi, në protestë kishin marrë pjesë mesatarisht 837 000 vetë. Pra atë ditë atje kishin marrë pjesë më së paku 670 000 e më së tepërmi 1.04 milionë protestues. Shifrat tona u pranuan si të sakta nga të dyja palët në mosmarrëveshje dhe me këtë përfunduan edhe zënkat. Në fakt për Farakhanin ky ishte një rezultat që assesi s'ishte për t'u nënçmuar.

- Si mundët ta fiksonit këtë?

- Të them se kjo është një e fshehtë profesioni! Vetëm këtë t'Jua them se unë dhe ekipi im, nëse e lyp nevoja mund t'i numërojmë madje edhe kokrrat e rërës së ndonjë bregdeti ose edhe të një shkretëtire të tërë.

- Po më habitni fare, i nderuari profesor!

- Po, pikërisht kështu...Në qoftë se i përdorni ligjet e shkencës edhe kjo është e mundur. Për më tepër, në të kaluarën ka pasur raste edhe kur kam numëruar rërë të shkretëtirës. Mirëpo, natyrisht se në të gjitha këto numërime ekziston një masë mundësie për gabim. Me rastin e botimit të studimeve tona këtë mundësi gabimi e theksojmë patjetër. Si do që të jetë, ne arrijmë të shifrat që të interesuarve të mund t'u japin një ide lidhur me çështjen në fjalë. Këtu dua të theksoj se Qendra jonë në vitin 1997 nga ana e administratës së NASA-s është zgjedhur si "Centre of Excellence in Remote Sensing" (Qendra e Përsosjes në Teleperceptim).*



Prof. Dr. El-Bazi me ekipin e tij, me të cilin bëri llogaritjen numerike të pjesëmarrësve në marshimin “Një milion burra” të organizuar nga Farrakhani më 1995 në Washington.

* Ata që janë të interesuar për më tepër hollësi lidhur me këtë studim të el-Bazit, mund t'i qasen linkut si vijon: www.bu.edu/remotesensing/Research/MMM/MMMnew.html .

“Apollo 15 në Hënë shkoi me suren el-Fatiha”

- Në vitin 2000 në një dokumentar me titullin “To The Moon” në kanalin televiziv National Geographic pata dëgjuar që para se Apollo 15 të fluturonte për në Hënë, Ju i kishit dhuruar komandantit të misionit David Scott një Kur’an për ta mbrojtur ekuipazhin e tij prej rreziqeve. I habitur nga kjo më vonë shkrova një artikull në revistën tonë lidhur me këtë. Artikulli në fjalë për një herë mori dhenë dhe u fut në shumë faqe interneti të vendit (Turqi). * Meqë jam në kontakt direkt me Ju, dëshiroj t’i mësoj të gjitha detajet e kësaj prej gojës Suaj. Ai Kur’an a shkoi vërtet në Hënë dhe nëse po a është akoma atje?

- I nderuari Ali, jam i njoftuar për lajmin tënd të botuar. Në letërkëmbimin e parë elektronik ma pate dërguar edhe linkun e atij shkrimi. Të falënderoj për kujdesin dhe interesimin që po e tregon lidhur me këtë kujtim shumë kuptimplotë! Njëri prej nxënësve të mi më të mirë në Universitetin e Bostonit është një turk. Quhet Mutlu Özdoğan. Është një shkencëtar shumë i vlefshëm prej të cilit pres shumë në të ardhmen. Me një përkthim të përgjithshëm të artikullit që ma bëri ai e studiova mirë dhe u gëzova shumë.

Ato që i kam thënë në programin e cekur të National Geographic përgjithësisht i kishe kuptuar shumë drejtë dhe drejtë edhe i kishe bartur në shkrimin tënd. Përjashtim bënin disa mangësi të vogla, të cilat nëse dëshiron mund t’i plotësoj tani.

- Me gjithë qejf, i nderuar!

- Rrënjët e kësaj ngjarjeje që për mua ka një kuptim të thellë emocional shtrihen në tri udhëtimet e fundit të Apollos për në Hënë, pra të misioneve Apollo 15, 16 dhe 17. Pas këtyre fluturimeve NASA zaten e mbylli librin e saj për në Hënë. Këto tri fluturime kishin shumë dimensione të ndryshme nga të parat – Apollo 11, 12, 13 dhe 14. Së pari me Apollo 15 në Hënë do të dërgonim një automobil dyvetësh që punonte me energji elektrike. Është fjala për veturën e Hënës që shpesh nëpër dokumentarë kenë mund ta ndiqni si një me antenë dhe e zbuluar përsipër, që zyrtarisht quhej “Rover-1”. Në të njëjtin udhëtim anijen do ta ngarkonim edhe me dy kamera televizive me ngjyrë, me ekuipazhin e duhur

* Për të intersuarit: www.yenisafak.com/arsiv/2003/ocak/19/tarih1901.html.

anësor të tyre si dhe me pajisjet e duhura për astronautët që atje do të bënin kërkimet e tyre kimike.

Apollo 15 ishte një udhëtim tepër i guximshëm për të cilin të gjithë ne i luteshim Zotit që të kishte mëshirë përgjatë gjithë fluturimit të anijes. Anija ishte e stërmbushur deri në grykë, që s'ishte parë në fluturimet e mëhershme. Kjo u bë nga arsyeja sepse e dinim se së shpejti do të përfundonte programi për Hënën dhe dëshironim që astronautët kësaj radhe të sillnin aq njohuri sa kishin sjellë në tri herët e tjera. Për shkaqe financimi, ndoshta edhe një herë nuk do të mund të shkohej në Hënë.

Siç thash edhe më parë, shumicën e astronautëve të Apollos i kam trajnuar unë vetë. Fushat e specializimit tim bazor janë gjeologjia dhe kimia. Krahas gjeologjisë së globit të Tokës, njihem edhe si i profesionalizuar edhe në fushën e "lunar science" (shkencës së Hënës). Kam njohuri të mjaftueshme rreth formimit dhe strukturës së sipërfaqes së satelitit të Tokës. Për këtë arsye dhe NASA mua dhe ekipit tim na ngarkoi me detyrën e fiksimit të pikave të zbritjes dhe të llogaritjes matematikore të aterimit në Hënë të pajisjeve me rastin e misioneve të Apollos. Mendoj që i kam zgjedhur vendet e sakta, pasi të gjithë ata i kryen detyrat e tyre me sukses dhe janë kthyer shëndoshë.

Kontributi im trajnues u intensifikua sidomos në tri misionet e fundit të Apollos 15, 16, dhe 17. Atyre ua mësoja se në cilat pika të Hënës duhej të zbritnin, ç'duhej të bënin me rastin e aterimit, si duhej të silleshin pas aterimit në sipërfaqen e Hënës dhe se çfarë forma shkëmbinjsh do të ishte më mirë të mbledhnin atje etj.

Në sipërfaqen e Hënës një astronaut mund ta shkatërrojë veten dhe shokët e tij për disa sekonda vetëm me një hap të gabueshëm. Fjala vjen, me një gjest të gabueshëm ai mund të përmbysset e ta thyejë vizorin e helmetës, kurse kjo do të thotë që atij për disa sekonda t'i zihet fryma e të vdesë. Po kështu ai mund të prekë një gjësend që s'duhet ta prekë e të shkaktojë çarje të veshjeve të tij ose të bart në anije ndonjë mostër gjeologjike me shtrirje të gjerë të rrezeve radioaktive e ta vërë kështu në rrezik jetën e ekuipazhit të tij. Të gjitha skenat e mundshme të lëvizjeve lidhur me këto çështje astronautëve ua kemi përcjellë qysh në fazën e trajnimit të tyre.

Secilit ekip mesatarisht nga dy vjet radhazi i kam dhënë mësim aktiv. Sa më shumë që afrohej koha e detyrës tanimë mua fillonin të më shihnin më tepër se edhe bashkëshortet e tyre, me çka mes nesh krijohesh një miqësi e fortë.

Mirëpo, me rastin e përgatitjeve për lansimin e Apollo 15, për arsyet që i përmenda më parë, ishim në një gjendje mjaft të tensionuar të cilën s'mund ta fshihte asnjëri prej nesh. Një anije e ngarkuar deri në këtë masë a do të mund të mbërrinte shëndoshë në Hënë? Nëse ia del të mbërrijë, kësaj radhe si do të ishte kthimi prapë në Tokë? Na mori vite të tëra përgatitja dhe trajnimi i tyre për këtë

detyrë, prandaj edhe ata edhe anija ishin shumë të vlefshme për ne. Kush dëshiron t'i mbyten shokët në thellësitë e hapësirës?!

Pak para se të lansohej Apollo 15 unë u takova me komanduesin e anijes kolonelin David Scott. E shqyrtonim modulën e komandës dhe përnjëherë i them: “Miku im i dashur Dave (Dejv), për të mbetur ju të gjallë brenda kësaj kutie të teneqtë ne kemi bërë gjithçka që na porosit mendja, logjika dhe shkenca. Pas kësaj fillon faza e besimit. Unë, nëse më lejoni Ju si komandues, dëshiroj që kësaj anijeje t’ia shtoj edhe një mekanizëm mbrojtës të besimit tim”.

Me kërshtëri pyeti: “Ç’ke ndër mend të bësh?”. I thashë: “Në trupin e anijes do ta vendoj el-Fatihane që është sureja e parë e Kur’anit. Ajo përbën thelbin e Librit tim të shenjtë. Për momentin kjo ideja ime mund t’Ju duket e pakuptimtë, mirëpo unë me këtë do të mendoj se Ju kam lënë në dorë të Zotit”. Pas kësaj menjëherë ia sqarova kuptimin e Fatihasë.

Dave ishte një i krishter i sinqertë, mirëpo në asnjë mënyrë nuk ma mori për të madhe. “Mbret” tha, “Të lutem bëje këtë, sepse jam tepër i tensionuar dhe ne gjatë këtij fluturimi kemi nevojë për çfarëdo që do të na mbrojtë! Sureja Fatiha gjithsesi le të gjendet në anijen tonë!”.

Përfundimisht, më 26 korrik 1971 Apollo 15 shkoi në Hënë duke e bartur me vete suren el-Fatiha. Pranë ekipit pati edhe një Kur’an të vogël. Edhe përkundër mijëra rreziqeve të mundshme nuk ndodhi asnjë mbrapshti. Pa kurrfarë problemi shkuan në Hënë dhe zbritën në rrëzë të Maleve Apenine në zonën e “Detit të shirave”, i vendosën kamerat, i bënë eksperimentet, e startuan automobilin dhe dolën në shëtitje e me këtë arritën të bëhen astronautët që deri më atë ditë e kanë arritur pikën më të largët se “Merimanga”. Ata ndenjën në sipërfaqen e Hënës gjithsej 66 orë e 54 minuta dhe ky ishte qëndrimi më i gjatë që ishte realizuar deri më atëherë. Derisa zgjaste ky udhëtim mua këtu në Qendrën Hapësinore Kennedy madje nuk më kujtohet numri i duave që i kam lexuar. Sepse sikur astronautët e Apollo 15-tës të pësonin gjatë udhëtimit të tyre, fluturimet për në Hënë do të hiqeshin përgjithmonë nga rendi i ditës dhe ne, me gjithë këtë katastrofë, nuk do të mund t’i realizonim edhe dy fluturimet e fundit që historisë së shkencës i kanë ofruar një bagazh të madh njohurish. Qeveria amerikane asokohe ndeshej me presionin e madh të grupeve kundërshtarë të cilat thonin: “A thua është shumë e nevojshme të mundohemi ta zbulojmë Hënë, përderisa në Tokë dhe në Amerikë ka probleme ekonomike të pakapërcyeshme?!”. Këto ishin fluturime skajshmërisht të shtrenjta që secila prej tyre kërkonte një buxhet prej mbi një miliardë dollarë. NASA, për shkak të fluturimit shumë të suksesshëm të Apollo 15-tës, me një përpjekje të fundit i futi në qarkullim edhe misionet numër 16 dhe 17. Me këtë ne zaten, pas kësaj pike, patëm përfituar më tepër se edhe njohuritë që mund të merreshin nga Hëna.

Unë nuk jam një njeri që kam besëtytni, unë jam një shkencëtar. Zbrazëtira hapësinore është rreziku më i madh që mund të paramendohet për organizmin e

njeriut. Në një operacion kaq të madh nuk mund të mbështetesh vetëm në besimet tua e t'i shpërfillësh masat dhe seriozitetin shkencor. Kjo madje bie ndesh edhe me frymën e përgjithshme Islamit. Por unë besoj se All-llahu xh.sh. ato ditë ka dashur që ky ekip të hapet me sukses në thellësitë e hapësirës dhe që të gjitha qeniet njerëzore në tokë të mund t'i shohin pasuritë e gjithësisë me gjithë madhështinë që e kanë. Më duket se me këtë vullnet Ai na hapi rrugën deri në skaj. Juve po ju flas jo për nivelin e sotëm teknologjik, por për atë të vitit 1971. Në të vërtetë unë edhe sot në u kërkofte, përtoj ta organizoj të njëjtin udhëtim me teknologjinë moderne. Sikur jeni të njoftuar, midis viteve 1986 – 2003 NASA ka humbur dy anije kozmike me gjithë ekuipazhin që kishin brenda. Së këndejmi ti ke teknologjinë që 30 vite e këndej ka treguar një zhvillim marramendës. Mirëpo këtë nuk kam mundësi ta them për teknologjinë e asaj kohe. Sistemet elektronike që i drejtonin anijet kozmike ishin shumë më të thjeshta. Zaten James Irwin, që ishte njëri prej dy astronautëve që e bënë këtë fluturim në Hënë, menjëherë posa u kthye në Tokë doli në pension dhe filloi të drejtonte një Fondacion Krishter që quhej “Fluturimi i lartë” dhe deri në fund të jetës së tij jetoi si besimtar.

- Irwinin edhe populli turk e njeh për së afërmi. Kah vitet 1980 ai pati ardhur në Turqi për ta kërkuar Anijen e Nuhut a.s. dhe nja dy herë pati dalë në kodrën e quajtur Ağrı Dağı. Madje më kujtohet se në njërin prej këtyre ngjitjeve në kodër ai e pati thyer këmbën dhe u shtri në spital. Ç'fat i çuditshëm, ia doli të shkonte e të kthehej shëndosh e mirë në Hënë, kurse në seruvenin e alpinizmit në Turqi nuk e pati të njëjtin fat.

- Po, edhe unë jam i njoftuar për kërkimet që ka bërë ai në këtë drejtim. Atë e humbëm në vitin 1991 nga kriza e zemrës në një moshë të re. Ai ishte njëri prej 12 të veçantëve që në historinë njerëzore pati nderin të shkelte në Hënë. 11 të tjerët janë akoma gjallë dhe me shumicën prej tyre takohem kur me jepet rasti. Të gjithë atyre u dëshiroj jetë të gjatë!

- I nderuar, ndoshta pyetja e radhës do t'ju mërzisë ca, mirëpo meqë jemi në kontakt nuk mund të kaloj pa Jua parashtruar edhe këtë pyetje. Me siguri që edhe Juve ju kanë mbërritur fjalët që prej vitesh dalin nga persona e grupe në Amerikë e në Angli, sipas të cilave në fakt askush nuk ka shkuar në Hënë, se qeveria amerikane të gjitha fotografitë e filmat e incizuar me rastin e misioneve të Apollos ka porositur të përgatiten në një hangar në Nevada. Në të vërtetë, nëse shikohen të dhënat shkencore që janë në dispozicion kjo mbase duket shumë qesharake, mirëpo fakti se shumë skeptikë herë pas here në disa fotografi të Hënës kanë gjetur disa të dhëna që bijnë ndesh me shkencën e optikës, kjo akoma vazhdon t'i ushqejë edhe

më tej këto dyshime. Pastaj, një arsye tjetër që i mban gjallë këto dyshime është edhe mosparaqitja e NASA-s me përgjigje të kënaqshme përpara opinionit lidhur me disa kundërshti logjike që vërehen në ato fotografi... Disa burime që i prodhojnë këto teori konspirative (komplotiste) thonë që Ju jeni “njëri prej atyre që dini shumë” për këtë çështje... Pretendimet se assesi nuk është shkuar në Hënë a Ju mbërrijnë edhe Juve me rastin e veprimtarive Tuaja shkencore në SHBA? Si reagoni kur takoheni me njerëz që mendojnë kështu? A zemëroheni, rrini heshtur apo bëni sqarime për t’i mënjanuar këto pretendime?

- Nuk jam zemëruar asnjëherë dhe nuk zemërohem për pyetje të këtilla, ngase njerëzit kanë të drejtë të interesohen të dinë gjithçka. Me pyetje të këtilla edhe këtu në SHBA ndeshem shpesh dhe të gjitha atyre mundohem t’u përgjigjem me durim. Vetëm këtë t’jua them: Unë me vëmendjen më të madhe i kam ndjekur të gjitha antitezat e individëve apo grupeve kundërshtarë që nga viti 1970 kur filluan të qarkullojnë thëniet se “Në të vërtetë kurrë nuk është shkuar në Hënë dhe se NASA neve na mashtron e gënjen”. I kam lexuar librat dhe artikujt e gazetave që ata i kanë shkruar dhe i kam ndjekur programet radiotelevizive të tyre. Definitivisht t’ju them se në asnjërën prej këtyre antitezave nuk kam mund të gjej bile një dëshmi të vetme serioze të shkruar apo fotografike që do të mund ta dëshmonte të kundërtën e shkuarjes në Hënë. Ata me vite të tëra rrahin ujë në dybek. Në kuadër të programit të Apollos gjashtë anije që me sukses kanë ateruar në Hënë dhe 12 njerëz të zgjedhur që kanë zbritur në faqen e Hënës për secilën herë në Tokë na kanë sjellë me qindra kilogramë gurë e truall gjeologjikisht krejt tjetër fare nga gurët e truallit i Tokës. Madje edhe të gjitha kutitë e vulosura të tyre për herë të parë hapeshin përpara syve të mi si një gjeolog që isha. Shembujt e gurëve e të truallit që as një gram i tyre nuk u ngjan këtyre të Tokës, i kam prek vetë me këto duart e mia dhe me muaj të tërë i kam studiuar. Ç’të themi për bisedimet fotografike që i kam bërë unë nga qendra e kontrollit tokësor në Florida me astronautët, të gjithë nxënës të mi, që gjendeshin në Hënë? Ç’të themi për mijëra fotografi e filma katrorë? Ç’të themi për gjithë ato të dhëna shkencore të përfituara nëpërmjet këtyre fluturimeve? Ne me qindra vetë që gjendeshim në Qendrën Hapësinore Kennedy, a thua të gjithë ne përnjëherë shikonim ndonjë ëndërr? Unë nuk zemërohem me këta që kanë pretendime të këtilla, por më dhimbsen për shkak të paditurisë së tyre shkencore. Ata përpiqen të hedhin hije mbi njërin prej operacioneve më të suksesshme të historisë njerëzore duke u nisur vetëm nga disa zbulime estetike të imëta e të rralla që i ka bërë NASA mbi disa fotografi. Preras po ju them se astronautët tanë kanë shkuar në Hënë, edhe atë jo një por krejt gjashtë herë dhe unë kam marrë pjesë këtu në të gjitha herët si një nëpunës i lartë.

Udhëtimi i Apollo 15-tës, për shkak të arsyeve emocionale që i përmenda më lart, zë një vend shumë me rëndësi në jetën time profesionale. Prandaj edhe

shpeshherë sjell shembuj nga ky udhëtim. Sërish lidhur me pyetjen në fjalë po ju sjell një kujtimin tim që ka të bëjë me ekuipazhin e po të njëjtit udhëtim:

Mbas shumë muajsh pasi Apollo 15 me sukses shkoi dhe u kthye nga Hëna, një natë në një takim shkencor të NASA-s u takova me kolonelin David Scott i cili pranoi ta vendonte suren el-Fatiha në anijen kozmike. Mbasi përfundua takimin dolëm me të në park aty të ecnim bashkë. Në qiell t'i merrte sytë Hëna e plotë pesëmbëdhjetëshe. Dave u ndal dhe pa bëzajtur e shikoi gjatë-gjatë. Edhe unë nuk bëja zë, por vetëm e shikoja atë. Më në fund u kthye kah unë dhe m'i tha këto fjalë: “E di çka Farouk, Hëna është aq larg saqë unë akoma edhe tani nuk mund të besoj se kemi shkuar dhe se jemi kthyer që andej! Pa më thuaj, pashë Zotin, si e arritëm këtë?!”

Mbasi unë këtë fjalë habie e mosbesimi e kam dëgjuar nga goja e njërit prej atyre që vërtet kanë shkelur në Hënë, nuk mund t'u zemërohem njerëzve të cilët nuk mund të besojnë se me teknologjinë e vitit 1970 ka mund të shkohet në Hënë. Dyshime të këtilla mund të ndodhin, mirëpo nëse i lëmë mënjatë sajimet e fantazisë dhe i qasemi çështjes me seriozitet shkencor, atëherë nuk mund të ketë kurrfarë dyshimi për këtë. Të rinjtë muslimanë nuk duhet t'i përfillin pretendimet e këtilla, sepse duke u marrë me teori të këtilla komplotiste i humbin kohët e tyre shumë të vlefshme.



Ekipi i Apollos 15 i cili, në vitin 1971, në Hënë shkoi me suren “El-Fatiha”: (nga e majta) koloneli David Scott-kapiten i anijes, koloneli Alfred Merrill Worden dhe koloneli James Irwin.



Prof. dr. El-Bazi duke e marrë çmimin për Shërbim të Lartë të NASA-s, nga drejtuesi i Programit Hënor Apollo, Rocco Petrone.

“Muslimanët nuk duhet të tmerrohen nga Teoria e Evolucionit”

- Profesor i nderuar, sot në shumë vende të botës islame nëpër qarqet shkencore mbisundojnë ata që kanë ide materialiste... Është formuar një opinion sipas të cilit ata që merren me shkencat pozitive, për nga botëkuptimi që kanë, duhet të qëndrojnë në “krahun e majtë” të jetës politike. Në këto qarqe vërehet një trysni sipas së cilës ata që merren me shkencë lidhjet me Zotin duhet t’i kenë ose shumë të dobëta ose të jenë ateistë të pastër. Për shembull, ‘Teoria e Evolucionit’ e cila me vete bart shumë pikëpyetje dhe që pret sqarime plotësuese, nga qarqe shkencore socialiste opinionit i lansohet si një ligj i përdëftuar shkencor, kurse ata që këtë e pranojnë me dyshim nënçmohen duke u etiketuar si konservatorë.

Ndërkaq Ju gjatë gjithë karrierës Suaj aspak nuk keni ndjerë nevojën të vendoni një maskë të këtillë materialiste. Përkundrazi për çdo rast haptas keni deklaruar se Jeni një shkencëtar musliman.

Ç’thoni Ju për trysnitë e këtilla të mafias shkencore të mbështjellë nga ide majtiste dhe për luftën psikologjike që po zhvillohet kundër shkencëtarëve fetarë? Një person a nuk mund të jetë shkencëtar në qoftë se nuk ka ide materialiste?

- Fillimisht me ngulm po theksoj se është shumë gabim që gjithë njerëzit e shoqërive perëndimore të shihen si materialistë. Kjo është po kaq gabim sa edhe gjithë shoqëritë muslimane të shihen si njerëz që aspak nuk i japin rëndësi materiales, si njerëz të shenjtë që jetojnë vetëm në dimensionin shpirtëror. Mendoj se të gjitha shoqëritë janë një sintezë e këtyre dy botëkuptimeve ekstreme. Po e them troç e shkoqur se idealja është që All-llahu i Madhërishëm prej nesh kërkon që të jetojmë në një vijë baraspeshe ku nuk do të nëpërkëmbet apo shpërfilllet njëri dimension në dëm të tjetrit.

Gjatë dyzet viteve të fundit që i kam kaluar në shtetet perëndimore kam takuar shkencëtarë me ide të tilla siç i përshkruat Ju, por kam takuar edhe shkencëtarë që nga njohuritë e tij ka nxjerrë mësimet e duhura shpirtërore. Dua të them, se bota e shkencës nuk është një zonë “e humbur duarsh”. Në këtë drejtim assesi nuk duhet të jeni pesimistë.

Pika e dytë me rëndësi e pyetjes Suaj ka të bëjë me “Teorinë e Evolucionit”, në bazë të së cilës janë paraqitur mendime e botëkuptime të ndryshme...Mbase mund të të duket pak e çuditshme, mirëpo unë mendoj se, shikuar nga disa pika, Teoria e Evolucionit ka disa anë të përbashkëta me doktrinën e krijimit. Sepse kjo teori në të vërtetë futet në çështje shumë të gjera e të llojllojshme. Sipas meje është mangësi të mendohet se kjo teori përmban vetëm pretendimin e

shumënjohur – që me të drejtë i prek keq besimtarët – se “Babai i njeriut është një qenie në formë majmuni”.

Babai im ka qenë profesor dhe drejtues në Universitetin El-Ez’her të Kajros. Gjatë gjithë jetës së tij ai, mua dhe të gjithë vëllezërit e motrat e mia, na ka nxitur e inkurajuar që të ecim drejt dijes e ta përvetësojmë atë në çfarëdo forme qoftë dhe pa marrë parasysh burimin e saj. Madje duke e bërë këtë (kërkimin e dijes) ai nuk na ka këshilluar asgjë që do të mund të kuptohej si largim prej rrugës së Islamit. Atë që ai vazhdimisht na thoshte ishte kjo thënie: “Dija është një gjë e humbur e muslimanit, atë duhet ta merrni madje edhe në Kinë qoftë!”.

Në sajë të babait tim unë jam liruar nga ndikimi i dogmave dhe jam mësuar që rrethin dhe botën ta shikoj me një mendjegjerësi. Kjo formë qasjeje më vonë i ka hapur rrugë gjithë jetës sime.

“Teoria e Evolucionit”, sipas vetë emrit, është vetëm një teori. Një teori që ka nevojë të studiohet, të hulumtohet e të diskutohet rreth saj. Besimi i krijimit (se bota është e krijuar dhe se nuk është pasojë e evoluimit – sh.p.) ndërkaq nuk është teori, porse prapë sipas vetë emrit, është një besim, gjë që duhet besuar.

Meqë ra fjala këtu, po ju sjell në shembull nga vetë zbulimet e mia lidhur me Teorinë e Evolucionit. Unë arsimimin tim të magjistraturës e kam mbaruar në Universitetin e Assiutit në veri të Egjiptit në lëndën e gjeologjisë. Tema e përfundimit të magjistraturës kishte të bënte me mikrofosilet që i gjeta në një pjesë shkëmbi 60 milion vjeçar. Në përfundim të studimit tim, konstatova se qeniet e gjalla të detit të asaj kohe kanë treguar prirje për t’u zvogëluar. Sepse, burimeve ujore ku kanë jetuar ato, u ka munguar potenciali ushqyes për organizmat e tyre dhe për arsye të këtij kërcënimi ato, shkallë-shkallë kanë rrëshqitur drejt formave më të vogla. Tezën time e mbështeste edhe madhësia e guaskave të disa qenieve të gjalla të detit që me kalimin e shekujve kishin ndërruar seriozisht shumë dimensionet e tyre. Zbulimet që i arrita i botova duke i formuluar “Dwarfizmi / shkurtabiqësia / si pasojë e burimeve ushqimore”. Atë që këto qenie e kanë përjetuar, ka qenë pikërisht një pjesë e shkurtër e atij procesi të gjatë që disa e quajnë “evolucion”.

Tani, unë si një shkencëtar musliman qysh para 40 vitesh në Egjipt kam arritur në një zbulim të këtillë. Ç’ti bëj kësaj, ta mbuloj sikur të mos kishte qenë fare? Jo, këtu nuk ka diçka që bie ndesh me besimin tim, përse të ndjem i shqetësuar? Sipas besimit tim, All-llahu xh.sh. të gjitha organizmat e tokës i ka **krijuar** në një formë të përkryer në mënyrë që ato t’i marrin masat e tyre biologjike e t’i formësojnë në mënyrë të vazhdueshme organizmat e tyre sipas rrethanave të ndryshueshme të mjedisit ku ato jetojnë. Për të mbetur gjallë, ato që është dashur të zvogëlohen janë zvogëluar, atyre që u është dashur t’u rritet shtati u është rritur, ato që është dashur të notojnë e kanë mësuar notin, ato që është dashur të vrapojnë më shpejtë kanë vrapuar më shpejtë. Të gjitha këto ndryshime janë shtrirë në një proces të gjatë që ka zgjatur me miliona vite.

Në qoftë se Krijuesi ka dashur kështu, jeta ka vazhduar e këstillë. Po nëse nuk ka dashur kështu, atëherë ka krijuar shkaqe të përshtatshme shkencore përmes të cilave i ka dhënë fund ekzistencës së atij lloji. A mund të paramendoni që dinozaurët të mund të kishin jetuar bashkë në të njëjtën kohë me njeriun? Me siguri që në tokë do të kishin ndodhur gjëra shumë trishtuese e të frikshme. Mirëpo, procesi i quajtur “evoluim”, duke ndërhyrë në situatën – në një farë forme – i ka marrë ata nga bota qysh në fillim të rrugës. Këtë program selektimi që dikush i thotë “evoluim”, ne lirisht mund ta quajmë “Vullneti i plotë i Krijuesit”.

Shkurt, unë si shkencëtar musliman edhe nuk shqetësohem fort nga studimet evoluiste. Për më tepër, besoj se ata që merren me këtë fushë madje deri diku kanë arritur edhe rezultate mjaft të logjikshme. Hakimi (I Urti) i botës që është All-llahu i Madhërishëm, të njëjtën gjithësi në tërësi e ka krijuar sipas ligjeve shkencore. Ndërkaq procesi i krijimit vazhdon akoma sot e kësaj dite.* Çdo gjë që ndodh në gjithësi, si pasojë e “adetullahit” (ligjit të Zotit në natyrë – sh.p.), ka nga një shpjegim shkencor. Atë çka dijetarët mundohen ta bëjnë, ndërkaq është vetëm emërtimi i tyre. Nëse ka të atillë që pasi t’i shohë mrekullitë e Zotit sërish të mos besojë, kjo është fatkeqësia e tyre personale. Çdo gjë të re që zbuloj, mua si një musliman më shtohet e përforcohet besimi (imani).



Prof. Dr. Faruk El-Bazi në Qendrën Hapësinore Kennedy në Florida,
ku ka marrë përsipër detyra të larta gjatë fluturimeve kozmike të
Apollos ndërmjet viteve 1967-1972.

* Autori këtu me siguri e ka ndërmend ajetin 29 të sures er-Rahman : ()
„Dhe Ai në çdo moment është i angazhuar në çështje të reja“ – sh. p.

“Akoma nuk kam parë asnjë jashtëtokësor”

- I nderuari profesor, si një shkencëtar që keni marrë detyra kritike në hapat drejt pushtimit të hapësirës, emri Juaj përmendet shpesh nëpër faqe të internetit që kanë të bëjnë me UFO-t (Unidentified Flying Objects – Objektet fluturuese të paidentifikuara). Shumica e këtyre web faqeve për fat të keq emitojnë programe fare larg seriozitetit shkencor dhe më tepër i qasen çështjes nga aspekti i fantazisë. Mirëpo, sipas mendimit tim, çështja e jetës në planetet e tjera nuk është temë me të cilën duhet të merren vetëm ata të dhënët pas imagjinatës ose vetëm Hollywoodi, porse edhe shkencëtarët seriozë të kësaj lëmie...

Këto grupe edhe për Ju thonë se jeni ‘një anëtar shumë i rëndësishëm i ekipit që i fshihni të dhënat për jetën në planetet jashtëtokësore që keni arritur t’i mblidhni me rastin e fluturimeve të Programit Apollo’. Sipas tyre, Ju jeni shkencëtari i rrallë në botë që e posedoni këtë “top secret”. Gjatë viteve 1967-1972 sa kanë zgjatur fluturimet e Apollos, vërtet a keni hasur në të dhëna që flasin për jetë gjallesash inteligjente në Hënë? Si p.sh. a keni hasur në ndërtime arkitektonike apo mbeturina të qytetërimeve të kohës së lashtë që do të mund të mendohej se janë ndërtuar nga ana e jashtëtokësorëve..? Madje thuhet se astronautët gjatë fluturimeve të Apollos kanë fotografuar apo filmuar mjaftë UFO të cilat i kanë ndjekur këta gjatë fluturimit. Hipoteza të këtilla janë lansuar edhe viteve të fundit me rastin e fluturimeve kozmike pa njeri për në Mars. Ç’mendoni Ju për këto të thëna? Sillet diçka nëpër qarqet e NASA-s dhe ne nuk dimë gjë, apo..?

- Gjatë karrierës sime shkencore 40 vjeçare, deri më tani nuk kam mund të has në asnjë dëshmi që do të mund ta mbështeste pretendimin për jetën e jashtëtokësorëve. Për shkak të përgjegjësisive që i pata marrë përsipër jam ndodhur në pozita mjaft të larta shkencore, mirëpo vërtet kjo temë asnjëherë nuk është trajtuar as edhe në mënyrë indirekte bile. Për fat të keq, në duart tona si shkencëtarë akoma nuk kemi ndonjë film, fotografi apo material tjetër ‘jashtëtokësor’ që do të mund të merrej për “dëshmi”. Nëse i dëgjoni të dhënët pas fantazisë, do të shihni me qindra të këtilla dëshmi nëpër njësi të fshehta të qeverisë amerikane, mirëpo nëse më pyesni mua, akoma nuk kemi arritur në asnjë dëshmi më të vogël bile për këtë. Natyrisht, kur them “dëshmi” kam për qëllim të dhënat e njëmendta shkencore, e jo filmat apo fotografitë e kurdisura e të dizajnuara me mashtrime të thjeshta nga kërkues amatorë.

Për fat të keq, akoma nuk kemi mund të hasim në gjithësi gjurmë që do të mund të lidheshin me qenie inteligjente jashtëtokësore. Them “për fat të keq”, ngase

nuk kemi asnjë arsye që troç ta refuzojmë pretendimin për mundësinë e ekzistimit të jetës në planetë të tjerë. As nga aspekti fetar e as nga ai shkencor. Natyrisht se mund të ketë dhe unë sapo të arrij të mbledh ndonjë të dhënë për këtë nuk ndjej nevojën që këtë ta fsheh prej njerëzimit. Mirëpo deri më tani kam pasur shansin që jashtëtokësorët lëkurëgjelbër t'i shoh vetëm në filmat e Spielbergut!

- Vërtet pas kësaj kohe është shumë vështirë krijimi i një Faruk el-Bazi të dytë, por ne sërish duam që mga goja Juaj të marrim një porosi plot shpresë për të rinjtë muslimanë. Si njëri prej shkencëtarëve të zgjedhur të shkencës moderne, ç'do të ishin porositë Tuaja për muslimanët e brezit të ri që duan të jepen pas botës së shkencës? Nëse kihet parasysh botëkuptimi me paragjykime ndaj Islamit si dhe qasja indiferente ndaj shoqërive të Lindjes e qeverive perëndimore të cilat e kanë në duart e tyre drejtimin e institucioneve të mëdha shkencore, a mund të mendohet që nga Lindja të nxirren dhe zhvillohen shkencëtarë të tjerë ndërkombëtarë sikur Ju që do të kishin një renome e autoritet botëror? Apo mos ndoshta ky proces do të marrë fund me brezin Tuaj? Ç'i porositni të rinjtë muslimanë që dëshirojnë të bëjnë zbulime të reja e me këtë t'i kontribuojnë edhe botës islame po edhe shkencës globale?

- Natyrisht se me këtë rast kam disa porosi me rëndësi që dëshiroj t'ia përcillni rinisë muslimane. Prandaj, edhe këtë pyetje e quaj mjaft me rëndësi sa edhe parapraket.

Unë jam një person që jam rritur nëpër duart e profesorëve eminentë si të gjeologjisë ashtu edhe të teologjisë. Babai im, ashtu siç e përmenda edhe më lart, ka qenë profesor në njërin prej universiteteve me renome botërore, në El-Ez'her, dhe ai na ka rritur me një besim të dëlirë e të pastër. Ai vetë ishte një i arsimuar që dyert e zemrës ia kishte hapur çdo dege të shkencës. Prej nesh gjithnjë kërkonte që të lexonim, të studionim e ta kuptonim sa të mundnim gjithësinë. Nuk duhet harruar se në fenë Islame nuk ka asnjë porosi apo ndalesë që e pengon njeriun nga zhvillimi shkencor. Nëse i lëmë mënjane besëtytnitë e besimet qorre dhe flasim duke u mbështetur në frymën e Kur'anit, në Librin e All-llahut nuk do të mund të gjejmë dokrra e çmenduri të këtilla! Përkundrazi, përkundër mjaft besimeve të feve të tjera, Islami si fe e fundit nëpërmjet librit të tij të shenjtë, Kur'anit, na motivon e madje edhe na nxit haptas që të merremi me zbulimin e kësaj zbrazëtire të pafund të quajtur gjithësi me gjithë çfarë përmban ajo. Për një musliman që plotësisht e ka kuptuar frymën e Islamit, studimi i botës ku jeton, studimi i ekzistencave të gjalla e jo të gjalla që ndodhen në të si dhe studimi i gjithësisë, thjesht është ibadet (akt adhurimi).

Gjënë e parë që duhet ta bëjnë të rinjtë muslimanë të kohës sonë është që me gjithë shpirt të kapen pas fesë së tyre, ta rikthejnë vetëbesimin të cilin e shoh se u mungon dhe të pajisen me dituritë më të ndryshme e në masën më të madhe që të jetë e mundur. Edhe All-llahu po edhe Pejgamberi i Tij i ndershëm shpesh e kanë theksuar se “inJORanti, i padiJshmi do të jetë prej të humburve”. Njeriut që pajiset me shumë dituri i shtohet nderi e respekti si ndaj vetvetes ashtu edhe ndaj të tjerëve. Në vend që të merret me zënkat e njëri-tjetrit, ai mundohet t’i arsimojë dhe edukojë ata me dashurinë më të madhe.

Sikur unë të mos isha lidhur dhe dhënë kaq me vendosmëri pas leximit dhe pajisjes me njohuri, ndoshta tani do t’i jetoja vitet e fundit të jetës sime si një çoban i moshuar diku buzë brigjeve të lumit Nil. Sigurisht që me këtë nuk dua t’i përçmoj çobanët, një qytetërim i përparuar ka nevojë edhe për çobanë që e bëjnë mirë dhe si duhet punën e vet. Ama para kësaj, ne duhet të krijojmë e arsimojmë njerëz që do të jenë udhëheqës jo të kafshëve por të njerëzve. Për këtë arsye dhe unë gjithnjë prej Zotit kam lypur dijen, dhe Ai ma ka dhënë sipas dëshirës sime dhe ma ka mundësuar që të marr përsipër detyra e role të rëndësishme të cilat i përbëjnë pikat kritike të historisë së njerëzimit.

Më duhet të pranoj që brezi im nuk ka arritur që në botën arabo-islame të formojë e të zhvillojë një ‘vetëdije të fortë të ummetit’. Në vitet e rinisë sime, nëpër shtete të ndryshme islame frynin erëra të stërmadhuara nacionaliste, e herë-herë dominonin edhe idetë socialiste. Tani kur po kthehem të shikoj mbrapa, e shoh më mirë se shpëtimi i botës islame nuk qëndron në këto rryma e ideologji.

Ne në vitet e para të rinisë sonë nuk ishim gjithaq të vetëdijshëm. Mirëpo, me sinqeritetin tim më të madh po ju them se kam shumë më shumë shpresë te brezat e tanishëm të rinj të botës islame. Brezat e ardhshëm do të jenë të pajisur me dituri dhe si njerëz që do të tregohen e njihen me gisht do të jenë përfaqësues të denjë të Islamit në botë dhe do ta arrijnë atë që ne nuk kemi mund ta arrijmë. Në mesin e familjes gjithënjëzore edhe ummeti islam gjithsesi do ta ketë vendin e vet të merituar. Islami, në sajë të intelektualëve muslimanë në të ardhmen do të mund të identifikohet jo me terrorizmin e me prapambeturinë, por me “me të përparuarin”. Kërkoj prej të gjithë jush që të punoni sa më shumë! Nëse Faruk el-Bazi prej një fshati të vogël e të parëndësishëm të Egjiptit ka arritur gjithë këtë ta mbërrijë brenda jetës së tij të shkurtër, ju gjithsesi se mundeni akoma më tepër të bëni. Ngjituni për jetën dhe kini sukses! Islami nuk është feja e të humburve dhe e dështuesve. Edhe këtë mos e hidhni mendsh se nuk ka asnjë shtet serioz nuk mund arrijë kund duke i shpërfillur trutë (mendjet) e mëdhenj në sferën e punimeve shkencore që dalin nga bota islame. Të gjithë hapat e mëdhenj shkencorë që e kanë orientuar zhvillimin njerëzor, gjithnjë janë realizuar me inteligjencën dhe mundin e njerëzve të kombeve të ndryshme. Kur për herë të parë në Hënë është vënë këmba e njeriut, në NASA kanë punuar

mjaft shkencëtarë muslimanë, edhe sot punojnë po edhe në të ardhmen do të punojnë. Kjo për arsye se bota ka shumë për të mësuar prej nesh.

- Më në fund, i nderuari profesor, unë në emrin tim dhe në emër të gazetës sime Ju falënderoj përzemërsisht për kohën që e ndatë dhe për mundin që e dhatë me këtë rast për ta zhvilluar këtë intervistë tejoqeanike edhe përkundër angazhimeve Tuaja të mëdha në Universitetin Tuaj ku jeni i punësuar!

- Edhe unë ju falënderoj shumë për sinqeritetin dhe ngrohtësinë tuaj ndaj meje dhe përcillni selamet e përshëndetjet e mia te të gjithë vëllezërit tanë muslimanë!

(Për ata që dëshirojnë t'i dërgojnë mesazhe përshëndetëse prof. dr. Faruk el-Bazit në gjuhën arabe ose angleze, po e japim numrin e faksit të Qendrës për Teleperceptim pranë Universitetit të Bostonit: 001 617 353 32 00 . Kurse web faqja ku mund të informoheni më hollësisht me jetëshkrimin dhe veprimtarinë e tij, siç theksuam më lart, është: www.bu.edu/remotesensing/Faculty/El-Baz/FEBbio.html).

DR. FAROUK EL-BAZ
Director
Center for Remote Sensing
Boston University
725 Commonwealth Avenue
Boston, MA 02215-1401



Prof. Dr. El-Bazi, si një musliman që ka kontribuar në botën e shkencës e të afrimit ndërkulturor, në vitin 2002 ishte laureat i “Çmimit për Sukses”, të ndarë nga Qendra Islame e Kalifornisë së Jugut, që është njëra prej organizatave më të rëndësishme islame në SHBA.



Edhe astronauti i parë musliman në historinë e kërkimeve hapësinore, princi saudit Ahmed bin Salman Abdulaziz es-Su'udi është arsimuar e zhvilluar nën kujdesin e Prof. Dr. El-Bazit. Më 17 korrik 1985 princi Salman del në atmosferë me anijen kozmike Discovery me ç'rast fiton nderin e ‘njeriut të parë që fal namaz në hapësirë’. Në foton përsipër princi Salman duket në një konferencë me mësuesin e tij Prof. Dr. El-Bazin.





Prof. Dr. El-Bazi në Universitetin e Bostonit ku e drejton Qendrën për Teleperceptim, me studentët e tij të diplomuar nga vise të ndryshme të botës. Nga ana e studentëve muslimanë ai nuk shihet vetëm si një musliman, por për më tepër si një ‘lider’ i vërtetë.



Prof. Dr. Faruk El-Bazi, që në qarqet shkencore mbahet në duar si një shkencëtar eminent me nder të veçantë, në raste të ndryshme me dy kryetarët e SHBA-ve, George Bush dhe Bill Clinton...